

Nr. 6 Prot.

Tiranë, më 16 Janar 2020

Lënda: Kërkesë për verifikimin e pastërtisë së figurës së shtetasit **AGRON MALAJ**

Drejtuar: **PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**
Sektorit të Dekriminalizimit

Për dijeni: **AMBASADËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS,**
TIRANË
DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN, TIRANË
TË GJITHA AMBASADAVE TË VENDEVE ANËTARE TË BE,
TIRANË
PREZENCËS SË OSBE, TIRANË
ZYRËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS, TIRANË

Të nderuar,

Më datë 13.05.2019, shtetasi Agron Malaj, i biri i Rufat dhe Jeta, i datëlindjes 16.08.1980, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, ka dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në cilësinë e tij si kandidat për Kryetar të Bashkisë Mat, Formularin e Vetëdeklarimit nr. 3232, në përputhje me ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Pyetjeve nëse është ndaluar apo arrestuar ndonjëherë nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale, si dhe nëse është dënuar ndonjëherë nga autoritetet gjyqësore vendase apo të huaja me vendim gjyqësor të formës së prerë, rezulton se i është përgjigjur me PO. Ai rezulton se **është i dënuar, me vendimin nr. 57, datë 07.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që ka marrë formë të prerë më datë 18.10.1999, për veprën penale mbajtjes pa leje të armëve luftarake, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, me 10 muaj burgim.**

Sipas ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ky dënim përbën shkak për ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike. **Subjekti Agron Malaj, ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë**

publik, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit të Kuvendit nr. 17/2016.

Konkretisht:

1. Me vendimin nr. 57/1999 të Gjykatës së Matit, ai është dënuar për veprimet e kundërligjshëm të parashikuar në nenin 278/2 të Kodit Penal, që parashikonte se: *"Prodhimi i armëve dhe i municionit luftarak, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. **Mbajtja, blerja ose shitja e armëve, bombave apo minave pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet. Mbajtja e fishekëve të armëve të lehta luftarake pa leje të organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.**"*

2. Neni 2 i ligjit nr. 138/2015, parashikon se: **"Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen** deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, **kryetar bashkie** apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, **personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për: a) kryerjen e veprimeve** apo mosveprimeve **që përbëjnë vepër penale**, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, **278 paragrafin e parë, të pestë** e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal".

3. Ligji nr. 138/2015 dhe kjo dispozitë e tij janë botuar në Fletroren Zyrtare nr. 220, datë 22.12.2015 dhe kanë hyrë në fuqi më datë **7 Janar 2016**. Për këtë arsye, për të vlerësuar se cili ishte veprimi kriminal që sipas legjislatorit përbën kusht ndalimi për kandidim, duhet t'i referohemi Kodit Penal që ka qenë në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 138/2015. Në datën 7 Janar 2016, në fuqi ka qenë neni 278 i Kodit Penal, me këtë përmbajtje: *"1. Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. 2. Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. 3. Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve*

kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. 4. Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet. **5. Mbajtja e armëve, i bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.** 6. Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.”.

4. Siç rezulton edhe nga përmbajtja e dispozitës në fuqi të Kodit Penal, legjislatori në miratimin e ndalimit të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 138/2015, ka patur në kosideratë veprimin e kundërligjshëm të parashikuar në dispozitën që ishte në fuqi në Kodin Penal dhe konkretisht **“mbajtjen e armëve në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore” (paragrafi i pestë i nenit 278 të Kodit Penal)**. Duke qenë se Kodi Penal i është nënshtruar ndryshimeve të vijueshme, legjislatori në nenin 2 të ligjit nr. 138/2015, parashikoi që referimi për efekt ndalimi, nuk duhet të bëhet tek numritimi i dispozitës përkatëse, por tek veprimet apo mosveprimet që përbëjnë vepër penale, sipas numërimit të bërë nga Kodi Penal në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit të dekriminalizimit. Neni 278 i Kodit Penal ka pësuar ndryshime edhe në vitin 2015, që janë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 249, datë 14.01.2016 dhe që kanë hyrë në fuqi më datë 30 Janar 2016. Për pasojë, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 duhet t’i referohemi përmbajtjes së dispozitës që ishte në fuqi përpara këtij ndryshimi.

5. Paragrafi 1, i nenit 2 i ligjit nr. 138/2015 ka vendosur këto kushte për aplikimin e ndalimit:

- (i) subjekti i ndalimit duhet të ushtrojë një nga funksionet e përmendura, ku përfshihet edhe Kryetar Bashkie;
- (ii) vendimi i dënimit duhet të ketë marrë formë të prerë;
- (iii) dënimi i dhënë të jetë burgim.
- (iv) dënimi të jetë dhënë për një veprim që parashikohet si vepër penale nga paragrafi 5 i nenit 278 të Kodit Penal. Në rastin konkret bëhet fjalë për armëmbajtje pa leje në mjedise publike apo mjedise të hapura për publikun.
- (v) vendimi i dënimit të jetë dhënë nga autoritetet gjyqësore, brenda apo jashtë vendit;
- (vi) dënimi të mos jetë dhënë për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.

6. Nga analiza e vendimit të plotë nr. 57, datë 07.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, një kopje të së cilit e gjeni bashkëlidhur, rezulton se:

(i) i dënuari është Agron Malaj, kandidat dhe më pas i emëruar nga Edi Rama në votime moniste si Kryetar Bashkie, funksion që e bën subjekt të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015.

(ii) vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë më datë 18.10.1999;

(iii) dënimi i dhënë është me burgim dhe konkretisht është dënuar me 10 muaj burgim;

(iv) është dënuar për një veprim që parashikohet si vepër penale nga paragrafi 5 i nenit 278 të Kodit Penal (mbajtjen e armëve pa lejen e organeve kompetente shtetërore). Nëse i referohemi rastit konkret, në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, evidentohet se subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje në mjedise publike. Ligji nr.138/2015, i referohet veprimit të kryer, që korrespondon me anën objektive të veprës penale "armëmbajta pa leje në ambjente publike", që përfshihet në ndalimet e nenin 2, pika 1, shkronja "a" e ligji. Ndërkohë që ka lënë jashtë fushëveprimit të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 2 të ligjit "mbajtjen pa leje të armëve në banesë". **Fakti që legjislatori në ligjin nr. 138/2015 i referohet veprimit apo mosveprimit, pra anës objektive të veprës penale, dhe jo gjuhës dhe numëritimit të veprës penale, lidhet me faktin se Kodi Penal shqiptar ka pësuar ndryshime ndër vite si dhe faktit që ligji përfshinë edhe dënimet e dhëna nga autoritetet e huaja, sipas Kodit Penal në shtetin përkatës.**

(v) vendimi është dhënë nga një autoritet gjyqësor brenda vendit dhe konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

(vi) dënimi nuk është dhënë për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.

7. Për këtë arsye, shtetasi **Agron Malaj përmbush të gjitha kushtet për aplikimin e ndalimit për të ushtruar një funksion publik dhe është subjekt i parashikuar në pikën 1, shkronja "a" të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015.** Sipas pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 138/2015, për personat që parashikohen në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, **ndalimi** për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit **zgjat gjatë gjithë jetës.**

8. Në përputhje me vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, për efekt të verifikimit nëse personi është apo jo në kushtet e ndalimeve, sipas neneve 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Prokuroria e Përgjithshme, për

personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet:

- i) të administrojë menjëherë në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë me nr. 57, datë 7.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;
- ii) të konstatojë se dënimi është dhënë për një nga veprimet që përmbajnë veprat penale të përmendura në shkronjat "a", të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" (konkretisht, paragrafi i pestë i nenit 278 të Kodit Penal);
- iii) të përfundojë procesin e verifikimit sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, dhe t'ia përcillë organit përgjegjës (Komisionit Qendror të Zgjedhjeve) brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

Për këtë arsye, kërkojmë nga ana juaj që në zbatim të detyrimit të parashikuar nga neni 8 i ligjit nr. 138/2015, të bëni verifikimin përkatës dhe të konstatonit se subjekti **Agron Malaj**, është subjekt ndalimi për të kandiduar dhe ushtruar një funksion publik, sipas ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Kërkesa në përputhje me pikën 2 të nenit 7 të ligjit nr. 138/2015, paraqitet në emër të jo më pak se 500 shtetave me të drejtë vote. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 138/2015, bashkëlidhur do të gjeni nënshkrimet e jo më pak se 500 shtetave me të drejtë vote. Sipas ligjit organi i prokurorisë është i detyruar të nisë menjëherë procedurën e verifikimit të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, sepse sipas ligjit kjo kryhet sa herë kërkohet nga jo më pak se 500 shtetas me të drejtë vote.

Nisur nga interesi i lartë publik që paraqet kjo çështje, Partia Demokratike e Shqipërisë pret një verifikim dhe reagim institucional të shpjegët nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, me synimin që të arrihet qëllimin primar që ka ligji i dekriminalizimit.

Në pritje të dhënies rrugë kësaj kërkesë në përputhje me ligjin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
GAZMENT BARDHI**

